



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 13, datë 30.03.2020

**PËR
MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TE NDIHMËS EKONOMIKE NGA
FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE
FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN MARS 2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Ligjit Nr.57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike“, Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës Nr.2, datë 29.01.2020 "Për miratimin e kriterëve, për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike, si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës Nr.647, datë 23.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2020 si dhe Projekt-Buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2020-2022”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendëskryetarit Bashkisë z. Zhuljen Varfaj, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të përfitojnë Ndihmë Ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës 83 familje me një fond 276.320 lekë.
2. Të përfitojnë Ndihmë Ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar 6 familje me një fond 13.860 lekë. Ky fond do të jetë nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike.
3. Heqjen nga Skema e Ndihmës Ekonomike për këtë muaj gjithsej 4 familje nga fondi i Bashkisë për arsye të mëposhtme :

a. Njësia Administrative Nr. 2

Fatbardha Zeqir Bala

Punësohet

b. Njësia Administrative Nr. 5

Mirela Kujtim Rexhepi

Mungesë dokumentacioni

Mirela Mehmet Toshi

Mungesë dokumentacioni

Hasije Selim Fejzo

Mungesë dokumentacioni

4. Në muajin Mars 2020, futen në skemën e ndihmës ekonomike 1(një) familje, e cila është në nevojë, në kushte të vështira ekonomike, me probleme të ndryshme sociale dhe do të trajtohen me fond nga të ardhurat e Bashkisë Durrës.

a. Njësia Administrative Sukth

Gëzim Llapushi

Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 4860 lekë.

5. Rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike me fond nga Bashkia 0 familje.
6. Rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike deri në 6% e fondit të kushtëzuar 0 familje.
7. Për muajin Mars 2020, do të jenë përfitues të Ndihmës Ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar 6 familje:
- Gladiola Agim Muci Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2700 lekë
 - Bajame Besim Zyla Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë
 - Teuta Alush Drizati Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 3060 lekë
 - Bujar Buna Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë
 - Flutura Hajdar Herri Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë
 - Vjollca Shaban Jora Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2700 lekë
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social në varësi të Bashkisë Durrës.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Am Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.03.2020